



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024  
Nr. Dok. 202400952/2

**Lënda:** Rekomandim pas monitorimit të kryer në Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë "Ramazan Kabashi", Tiranë, për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve dhe trajtimit të fëmijëve/nxënës me aftësi të kufizuara

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR**

**TIRANË**

**BASHKISË TIRANË**

**DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DURRËS**

**ZYRËS VENDORE ARSIMORE TIRANË**

**DREJTORIT TË INSTITUTIT TË NXËNËSVE QË NUK SHIKOJNË  
"RAMAZAN KABASHI"**

**TIRANË**

Të nderuar,

Në kuadër të mandatit që institucioni i Avokatit të Popullit ka për mbrojtjen, garantimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijës, po ju drejtohem nëpërmjet këtij rekomandimi, për të ndarë me Ju konstatimet e gjetjet e inspektimit të realizuar në Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë "Ramazan Kabashi" Tiranë, si dhe problematikat që duhen adresuar në kuadrin e detyrave dhe kompetencave Tuaja ligjore për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtës së fëmijës për arsim, integrim dhe zhvillim, si dhe ushtrimin efektiv të kësaj të drejte në praktikë.

Gjatë veprimtarisë së tij, Avokati i Popullit u ka kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve me aftësi të kufizuara. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), si dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK). Kjo e fundit parashton tetë parime të përgjithshme, duke përfshirë “respektin për aftësitë në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre”. Në të bëhet u thirrje shteteve të nisin një ndryshim kulturor, duke theksuar barazinë, përfshirjen dhe mosdiskriminimin për fëmijët me aftësi të kufizuara.

### **Legjislacioni për arsimin e fëmijëve me AK**

E drejta për arsimim është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila duhet të gëzohet në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë nga të gjithë. Kushtetuta e RSh-së në nenet 57 dhe 59 të saj garanton të drejtën për arsim për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë pa dallim. Në këtë kontekst, fëmijë me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejtën për t’u arsimuar, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuara<sup>1</sup>.

*“Nxënës me aftësi të kufizuara është personi, i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara, që, në ndërveprim, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore<sup>2</sup>. Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr.69/2012), në nenin 3 përcakton se “1. Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit: a) të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; b) të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; c) të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës. 2. Në arsimin parauniversitar nxënësit: a) kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore; b) përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare; c) zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike; ç) zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit; d) aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; dh) aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës; e) zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes; ë) përdorin teknologjitë e reja”.*

<sup>1</sup>Komenti i Përgjithshëm nr.9 (2006), Komiteti i Gjenezës për të Drejtat e Fëmijëve, “Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara”, CRC/C/GC/9, 27.2.2007.

<sup>2</sup>Neni 2, pika 17 e ligjit 69/2012, i ndryshuar.

Në nenin 5 të po këtij ligji përcaktohet se “1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, **aftësia e kufizuar** ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislationin shqiptar”.

Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, nr.15, datë 24.07.2023 “Për vitin shkollor 2023-2024 në sistemin parauniversitar”<sup>3</sup>, në nenin 6, ka përcaktuar se DRAP/ZVAP në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare duhet të ndjekin me përparësi:

j-Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesve ndihmës sipas legjislationit në fuqi.

m-Hartimin dhe zbatimin e Planeve Edukative Individuale (PEI) për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Pjesë e sistemit parauniversitar publik në Shqipëri është edhe “Arsimi special publik” i garantuar në ligjin nr.69/2012<sup>4</sup>. Shkollat speciale, shërbejnë për arsimimin dhe integrimin e fëmijëve me AK, sipas kategorive e specifikave që ata paraqesin dhe janë pjesë e rrjetit të institucioneve shkollore parauniversitare publike në Shqipëri. Të tilla janë shkollat të cilat janë ngritur posaçërisht dhe funksionojnë aktualisht në disa qytete të Shqipërisë<sup>5</sup>. MAS dhe institucionet e varësisë për sektorin e arsimit, synojnë ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve e nxënësve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt për diversitetin. Arsimi gjithëpërfshirës nënkupton një mjedis të të nxënësve që mundëson akses, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit, që shkollat duhet të përshtaten për ta, pavarësisht gjendjes së tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore apo kushteve të tjera. Bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 69/2012, fokusi i arsimit të personave me AK është gjithëpërfshirja dhe aftësimi<sup>6</sup>. Pavarësisht se në nenin 86 të Rregullores

<sup>3</sup><https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/Udhezim-NR.15-date-24.7.2023-viti-shkollor-2023-2024-ne-sistemin-parauniversitar-PDF.pdf>

<sup>4</sup> Neni 63

<sup>5</sup> Neni 64, pika 4 e ligjit nr.69/2012, i ndryshuar “Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjejnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira”.

<sup>6</sup> Neni 63 i Ligjit nr.69/2012, i ndryshuar: 1. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t'i përgatitur për integrim

për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, është përcaktuar se shkollat e specializuara për nxënësit me aftësi të kufizuara shërbejnë si qendra burimore, *në RSH nuk ka asnjë shkollë publike speciale që të funksionojë edhe si qendër burimore për PAK*. Për transformimin e shkollave speciale në qendra burimore për aftësinë e kufizuara MAS, me urdhrin nr. 427, datë 2.11.2021, “Për përcaktimin e modelit të qendrave burimore për nxënësit me aftësi të kufizuara”, ka ngritur një grup pune *ad-hoc* me qëllim përcaktimin e modelit të qendrës burimore, duke shfrytëzuar kapacitetet dhe përvojën e shkollave speciale.

Me ndryshimet e fundit që i janë bërë ligjit nr.69/2012<sup>7</sup>, në nenin 64/1 janë dhënë këto përcaktime lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në qendra burimore: 1. **Qendër Burimore** është *institucioni i arsimit special*, që ka për qëllim të mbështesë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar në vijimësi rezultatet e të nxënësve dhe t’i përgatisë ata për *gjithëpërfshirjen dhe aftësimin* për jetën, duke zhvilluar aftësitë e duhura në të gjitha fushat e përditshmërisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë dhe mosdiskriminimin. 2. Me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin krijohen *qendrat burimore, si institucione arsimore parauniversitare që ofrojnë arsim special dhe shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara*, sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. 3. Qendrat burimore kanë punonjës të specializuar në aftësinë e kufizuara, si mësues të arsimit special, mjekë, punonjës të shërbimit psikosocial, terapistë, që ofrojnë shërbime mbështetëse dhe rehabilituese të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara edhe në shkollat e zakonshme. 4. Qendrat burimore sigurojnë mbështetje për gjithëpërfshirjen, në kuadër të burimeve që kanë në dispozicion, në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore parauniversitare, që arsimojnë nxënësit me aftësi të kufizuara. 5. Kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Për zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse në arsim dhe rekomandimit të Komitetit të KDPAK-ut është vendosur shndërrimi i shkollave speciale publike në qendra burimore.

---

të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. 2. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore. 3. Nxënësve, që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Brail

<sup>7</sup> <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2012/06/21/69>, L.44/2023, datë 15.06.2023

Mbi këtë bazë, VKM nr.148, datë 13.03.2024 “Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen e riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre” ka përcaktuar kriteret dhe procedurat për riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore. Riorganizimi i një institucioni të arsimit special në qendër burimore është *procesi i zgjerimit dhe i shtrirjes së aktivitetit të tij përtej arsimit special, duke ofruar shërbime mbështetëse dhe rehabilituese të specializuara për nxënësit me aftësi të kufizuara edhe në shkolla të zakonshme, si dhe trajnime për punonjësit arsimorë*<sup>8</sup>.

Po kështu, në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026<sup>9</sup> parashikohen ndër të tjera, si objektiva edhe:

**“A1.3.3. Fuqizimi i shkollave speciale dhe kthimi i tyre në qendra burimore për aftësinë e kufizuara.** Duhet zhvilluar role të reja për shkollat speciale duke i konvertuar ato në qendra burimore me një diapazon të gjerë funksionesh në dobi të mbështetjes së arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në ato rajone ku mungojnë shkollat speciale, do të caktohen, fillimisht në formë pilotimi, shkollat që duhet të funksionojnë si qendra burimore për gjithë rajonin, duke marrë për bazë modele tashmë të pilotuara në disa zona të vendit.

**A1.3.4. Pajisja e shkollave me mjete dhe programe teknologjike për t’u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara.** Disa nga programet teknologjike dhe mjetet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara janë: programe kompjuterike të ndryshme për fëmijët me vështirësi në shikim, dëgjim, vështirësi në të folur; makina llogaritëse për fëmijët që vuajnë nga diskalkulia; libra audio; monitor/ekran me prekje; set me puzzle/ngjyra/lodra/fletore; libra me figura; i-pad-e; pecc (komunikim nëpërmjet figurave), etj.

**A1.3.5. Përmirësimi i aksesueshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara në çdo shkollë dhe në të gjitha mjediset e shkollës.**

**A1.6.1. Investime për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore. Kjo infrastrukturë do të përshtatet për aksesin e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike,** por edhe sa i takon aspekteve të higjienës, duke respektuar nevojat e veçanta të vajzave dhe djemve, si dhe aspekteve të sigurisë”.

Institucioni i AP-së, në komunikimin administrativ me përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor, ka synuar jo vetëm zgjidhjen e problematikave të parashtruara dhe evidentuara për fëmijët me AK, por edhe nxitjen e institucioneve përgjegjëse, sa i takon zbatimit korrekt në praktikë të

---

<sup>8</sup> Paragrafi 8 i Dispozitave të Përgjithshme të VKM datë 13.03.2024

<sup>9</sup> Miratuar me VKM nr.621, datë 22.10.2021

legjislacionit të arsimit parauniversitar<sup>10</sup> dhe adresimit të problematikave konkrete në nivel vertikal, për zgjidhjen e të cilave kërkohet angazhimi i institucioneve politikbërëse.

“Gjithëpërfshirja ka qenë në fokus të politikave arsimore në Shqipëri në dekadën e fundit, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme, pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga grupet vulnerabël, si dhe transformimin e shkollave të specializuara në qendra burimore për nxitjen e zhvillimit profesional të mësuesve dhe mësuesve ndihmës të shkollave të zakonshme, të cilët do të punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara. MAS-i është angazhuar të sigurojë arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, por *shkollat ende nuk përmbushin gjithë standardet e gjithëpërfshirjes, si infrastruktura dhe ambientet fizike në shkolla, kurrikula, vlerësimi, pajisjet për aftësinë e kufizuar*”<sup>11</sup>.

Një nga objektivat kryesorë të VKM-së nr.276, datë 12.05.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar për personat me aftësi të kufizuara 2021-2025”<sup>12</sup>, është *sigurimi dhe ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara*. Dhe më tej, e përkthyer në këto nënobjektiva:

- Rritja e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me lloje të ndryshme të AK-së;
- Shndërrimi i shkollave të specializuara në qendra burimore, duke përfshirë dhe duke mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës.

MAS-i dhe institucionet e varësisë informojnë dhe ndërgjegjësojnë në mënyrë të vazhdueshme nxënësit dhe prindërit, në lidhje me të drejtat e barabarta të fëmijëve me aftësi të kufizuara për t’u arsimuar në sistemin e përgjithshëm. Kjo realizohet përmes udhëzimit të vitit shkollor dhe njësive të shërbimit psikosocial në shkolla. Çdo fillimviti MAS-i udhëzon të gjitha drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) që të informojnë prindërit e interesuar dhe

---

<sup>10</sup> Neni 65 i ligjit 69/2012, mbi organizimin e arsimit të fëmijëve me AK parashikon se 1. Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta. 2. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës. 3. Nxënësi me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve. 4. Njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore u siguron nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria.

<sup>11</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf>

<sup>12</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/05/12/276/0426afc6-f905-4823-b2dd-1947a8fab811>

komunitetin për përparësitë e arsimit të fëmijëve me AK-në në arsimin gjithëpërfshirës.

## **1. Objektivat e inspektimit**

Në zbatim të kompetencave ligjore monitoruese të Avokatit të Popullit dhe për të garantuar të drejtën për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve (SMPDF) realizoi një inspektim të përgjithshëm në Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë “Ramazan Kabashi”<sup>13</sup>.

SMPDF-ja zhvilloi inspektimin, duke patur parasysh objektivat si vijon:

- vlerësimi i cilësisë së punës së stafit të shkollës speciale, i dokumentacionit dhe procedurave që ndjekin;
- vlerësimi i kushteve dhe mjediseve të institucionit arsimor-shkollë speciale;
- vlerësimi social, psikologjik i nxënësve që ndjekin këtë shkollë speciale.

## **2. Metodologjia e monitorimit**

Grupi i inspektimit ka kryer inspektimin nëpërmjet:

- zhvillimit të bisedave paraprake me drejtuesin dhe stafin psiko-social të këtij institucioni të edukimit, informacion i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.
- monitorimit dhe inspektimit në vend të kushteve materiale në të cilat mësojnë fëmijët/nxënës me aftësi të kufizuara, ku përfshihen klasat, ambientet e përbashkëta, tualetet, ushqimi, kuzhina, higjiena, bombolat kundër zjarrit, ambientet e jashtme, etj.
- verifikimit të përputhshmërisë së gjendjes në vend me standartet e parashikuara në kuadrin rregullator.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i institucionit të Avokatit të Popullit kreu bisedën përmblylëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë të nxënësve, të cilëve iu adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit.

## **3. Organizimi dhe funksionimi i institucionit**

### **a. Profili i institucionit**

---

<sup>13</sup> Inspektim i realizuar me datën 7.06.2024

Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë “Ramazan Kabashi” (INNSH) funksionon si shkollë 9-vjeçare dhe është shkolla e vetme kombëtare që ofron arsimimin për fëmijët me vështirësi shikimi nga klasa parashkollore deri në klasën e nëntë. Vizioni i shkollës është përgatitja e nxënësve të denjë për të thyer barrierat dhe për t’u integruar njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë. Ajo funksionon bazuar në përcaktimet e legjislacionit për arsimin parauniversitar në RSH.

Programi i shkollës është i njëjtë me programin e shkollave publike, me tekste të përshtatura në gjuhën Braille, shkrim të zmadhuar dhe diferenca ngjyrash sipas nevojës së nxënësit. Shkolla mban lidhje të vazhdueshme me prindërit, duke i konsideruar ata si aktorë të rëndësishëm në ndërhyrjen e hershme.

Veprimtaria e kësaj shkolle është e rregulluar me Rregulloren e saj të brendshme<sup>14</sup>, e cila është e hartuar dhe punuar me grup pune, që përbëhet nga mësues, mësues ndihmës, nxënës, prindër dhe përfaqësues të tjerë nga komunitetet. Më pas ajo paraqitet për shqyrtim nga drejtori i institucionit tek bordi i institucionit, e më pas tek drejtuesi i Zyrës Vendore Arsimore Tiranë<sup>15</sup>. Shkolla ka një plan pune vjetor<sup>16</sup>.

Për vitin shkollor 2023-2024, kjo shkollë ka të regjistruar gjithsej 36 nxënës, në klasat nga 1-9, të moshës 6-16 vjeç<sup>17</sup>, nga të cilët 8 vajza dhe 28 djem. Po ashtu, ka të regjistruar 7 nxënës që ndjekin mësimin në distancë (online), pra numri i përgjithshëm i nxënësve të shkollës është 43 veta. Shkolla funksionon me konvikt, pra kontigjenti i fëmijëve/nxënës të kësaj shkolle ishte nga gjithë vendi.

## **Ndarja e nxënësve sipas klasave dhe gjinisë ishte si vijon:**

---

<sup>14</sup>Rregullore e brendshme e vitit akademik 2023-2024, miratuar nga Drejtoria e ZVA Tiranë, bazuar në Urdhrin nr.31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>15</sup> Me shkresën nr.199 prot., datë 17.11.2023, miratuar Plani Vjetor i shkollës, Rregullorja e Brendshme e Shkollës dhe Plani i veprimtarive të shkollës.

<sup>16</sup> Me urdhrin nr.6, datë 28.08.2023. Sipas nenit 34 të Ligjit nr.69/2012 që përcakton se: Bordi i institucionit arsimor 1. Çdo institucion arsimor ka bordin e tij të përbërë nga prindër, nxënës, mësues, përfaqësues të qeverisë vendore dhe të komunitetit. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor dhe i raporton për veprimtarinë e tij këshillit të prindërve të institucionit. 2. Detyrat kryesore të bordit janë: a) miraton planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit; b) miraton planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni; c) miraton kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor; ç) merr pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të drejtorit të institucionit arsimor dhe të mësuesit. Plani afatmesëm sipas nenit 49, kreu XI të “Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”, miratuar me Urdhrin nr.31, datë 28.01.2020

<sup>17</sup>Sipas nenit 84 të Rregullores së IAP (miratuar me Urdhrin nr.31, datë 28.01.2020 të MAS) moshë e pranimit në klasën e parë të fëmijëve në shkollat e specializuara është 6-10 vjeç Nxënësit qëndrojnë në shkollat e specializuara deri në moshën 19 vjeç.



Klasa përgatitore - 2 nxënës, djem ;  
Klasa e 1-rë - 4 nxënës: 1 vajzë dhe 3 djem;  
Klasa e 2-të - 3 nxënës, djem,  
Klasa e 3-të - 4 nxënës, djem;  
Klasa e 4-t - 2 nxënës, djem;  
Klasa e 5-të - 5 nxënës, 3 vajza dhe 2 djem;  
Klasa e 6-të - 6 nxënës: 2 vajza dhe 4 djem;  
Klasa e 7-të - 3 nxënës, djem;  
Klasa e 8-të - 1 nxënëse ;  
Klasa e 9-të - 6 nxënës, 1 vajzë dhe 5 djem.

Janë gjashtë fëmijë/nxënës që kanë më shumë se 1 diagnozë mjekësore, 4 djem dhe 2 vajza, për të cilët ka plan edukativ individual.

**Ndërsa ndarja e nxënësve sipas klasave dhe frekuentimit (ditor) ose në konvikt) ishte si vijon:**

Klasa përgatitore : 1 nxënës (djalë) nga Tirana dhe 1 vajzë në konvikt;  
Klasa e 1-rë – 1 nxënëse nga Tirana dhe 3 nxënës në konvikt;  
Klasa e 2-të – 2 nxënës nga Tirana dhe 1 nxënës në konvikt;  
Klasa e 3-të - 3 nxënës nga Tirana dhe 1 në konvikt;  
Klasa e 4-t - 1 nxënës nga Tirana dhe 1 në konvikt;  
Klasa e 5-të - 2 nxënës nga Tirana dhe 3 në konvikt;  
Klasa e 6-të - 4 nxënës nga Tirana dhe 2 në konvikt;  
Klasa e 7-të - 1 nxënës nga Tirana dhe 2 në konvikt;  
Klasa e 8-të - 1 nxënëse në konvikt;  
Klasa e 9-të – 1 nxënëse nga Tirana dhe 5 në konvikt.

Pra gjithsej 21 nxënës qëndronin në konvikt dhe 15 ishin me frekuentim ditor.

## **b. Stafi i institucionit**

Organika e këtij institucioni përbëhet nga 27 mësues dhe 20 staf mbështetës. Stafi pedagogjik i kësaj shkolle përfshin mësues të sistemit 4-vjeçar dhe të sistemit bachelor dhe master, si dhe mësues të ciklit të ulët, të cilët kishin vjetërsi të lartë në punë. Konkretisht, 9 mësues të diplomuar kishin kryer master për “Pedagogji të specializuar sociale dhe psikologji shkollore, bachelor dhe master”.

Po ashtu, në organigramën e shkollës përfshihet edhe stafi mbështetës, i përbërë nga 23 veta, në pozicionet “1- kujdestar integrimi” (diplomuar në punonjës social; 4-kujdestarë konvikti (diplomuar në gjuhë letërsi, sociologji, histori dhe shëndet publik), 1-mjek (diplomuar mjek i përgjithshëm), 1-infermiere (diplomuar për infermieri), 1 sekretare (diplomuar për menaxhim

institucionesh arsimore), 3-kuzhiniere, 3-roje, 2-punonjëse shërbim (garderobë e lavanteri), 1-teknik, 3-sanitare, 1-magazinier dhe 1 roje.

### **c. Mjediset dhe kushtet e institucionit**

Nga inspektimi rezultoi si më poshtë vijon:

Institucioni ka dy godina. Në godinën e parë gjendej administrata, zyra e drejtuesit dhe konvikti i nxënësve. Dhomat ishin të ndara sipas gjinisë dhe gjithsecila kishte tualet. Për kapacitetin aktual të nxënësve, mjediset ishin optimale.

Godina e parë:

*Në katin e parë* të godinës ishin tualetet për meshkuj dhe stafin, dhoma e garderobës për larjen dhe hekurosjen; zyra e shtypshkronjës, zyra e informatikës si dhe dhoma-studio për inçizimet e programit të kësaj shkolle “Dhuro zërin”. Me proaktivitetin e stafit drejtues të shkollës, me donacione këto studio ishin të pajisura në mënyrë bashkëkohore në funksion të procesit të edukimit të nxënësve të kësaj shkolle.

Po ashtu, në këtë kat ndodhet mensa dhe ambienti i gatimit, 2 depo, 2 ambiente magazine, një zyrë e financës/magazinieres. Në këtë kat kishte dhe 3 klasa, ndër të cilat njëra ishte klasë muzike dhe njëra klasë parashkollori.

*Në katin e dytë*, konvikti i vajzave me katër dhoma dhe një zyrë/dhomë infermieri; dhoma e kohë së lirë me TV, 3 dhoma fjetjeje me nga 7 shtretër me dollape, dyshemetë shtruar me parket dhe secila kishte tualetet brenda. Ngrohja kryhej me sistem kaldaje (kalorifer), por dhe me kondicioner.

Godina e dytë:

Në godinën e dytë, në *katin e parë* ishte salla e mësuesve, ndërsa në *katin e dytë* janë vendosur klasat (nga një klasë për çdo cikël) ku zhvillohet mësimi i kësaj shkolle. Po ashtu dhe dy tualete ishin të ndara sipas gjinisë. Megjithatë, tualetet nuk ishin të pajisura me shiritat dhe mbajtëse për fëmijët me vështirësi shikimi. Në tavanin e klasave vëreheshin shenja lagështire. Në ambientet e godinës së këtij institucioni arsimor ishin të afishuara në mënyrë të rregullt numrat e telefonit të urgjencës shëndetësore, të mbrojtjes kundër zjarrit (zjarrfiksit) dhe të policisë së shtetit.

Shkolla nuk ka palestër dhe oborri ishte i vogël. Ndërsa pjesa që përdorej për lojë ishte e paasfaltuar, pra në kushte jo të mira. Oborri i institucionit kishte nevojë të rregullohet, të shtrohet apo asfaltohet, për të garantuar sigurinë e fëmijëve.

Nxënësit nga Tirana konsumojnë tre vakte ushqimore: vaktin e mëngjesit (ora 7.30-7.50), një vakt të ndërmjetëm (ora 10.25-10.45), si dhe drekën (13.30-14.00). Ndërsa pjesa tjetër e nxënësve, që janë akomoduar në konviktin e shkollës konsumojnë edhe darkën (ora 18.30-19.00).

Orari i studimit në shkollë ishte 14.30-18.30, me një orar pushimi 16.30-17.30 me mësues ndihmës. Orari i mësuesve ndihmës ishte 13.00-19.00. Pas kësaj ore nxënësit kanë dy kujdestarë në shërbim.

Kapaciteti akomodues i kësaj shkolle me konvikt, bazuar dhe në numrin e shtretërve ishte 50 veta.

Përmirësimet e fundit ligjore për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike janë realizuar me Vendimin nr. 511, datë 27.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar. AP-ja konstaton se masa e kuotës financiare të ushqimit në mensa e konvikte është përcaktuar me vendim qeverie dhe duhet të indeksohet çdo vit në varësi të inflacionit për të realizuar të drejtën për ushqim të shëndetshëm, si pjesë e të drejtave njerëzore bazë të njeriut theksuar në Konferencën Ndërkombëtare të Ushqyerjes, në vitin 1992, dhe në Samitin Botëror të Ushqimit në 1996, bazuar në ligjin nr 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

#### **d. Shërbimet**

Shkolla ofron arsim dhe programe zhvillimi për nxënësit që nuk shikojnë. Nga inspektimi rezultoi se 6 nxënës kanë Planet Edukative Individuale (PEI)<sup>18</sup>, pasi punojnë me kurrikula të veçanta dhe kanë një plan të aktiviteteve social-kulturore. Sipas udhëzimeve të ZVA-së plani PEI hartohet nga shkolla.

Jo të gjithë nxënësit e kanë planin edukativ individual (PEI). Çdo tre muaj, mësuesja kujdestare në bashkëpunim me stafin dhe prindin e nxënësit harton

---

<sup>18</sup>Hartimi i planeve edukative individuale në bashkëpunim me prindërit, në përputhje me prindërit në përputhje me nenin 82, pika d, kreu IV të “Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”, miratuar me urdhrin nr.31, datë 28.01.2020.

PEI-n për nxënësit. Ndërsa fëmijët/nxënësit pa PEI, ndjekin mësimin normal, pasi tek kjo shkollë ka program “Brail” dhe “Me shkrim të zmadhuar”.

Regjistrimi i nxënësve në këtë shkollë kryhej nëpërmjet sistemit *e-albania*, dhe vendimeve të KMCAP-it dhe KVA-së<sup>19</sup>. Regjistrimi i fëmijës në klasën e parë bëhet sipas një formulari të plotësuar nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, e cila është e përshtatur në gjuhën Braille, në rastet kur prindërit janë me vështirësi në shikim. Nxënësit regjistrohen në institucionin arsimor special të nxënësve që nuk shikojnë nga i gjithë vendi, nisur nga statusi i shkollës kombëtare. Pranimi i nxënësve në INNSH i referohet kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për statusin e të verbrit. Nisur nga specifika e shkollës, kapaciteti dhe mundësitë e shërbimit që ofron, është ngritur grupi i vlerësimit i përbërë nga drejtori, zëvendësdrejtori, shërbimi psiko-social, mësues dhe stafi i shërbimit shëndetësor, i cili përveç shqyrtimit të rastit, shqyrton dhe përmbushjen e dokumentacionit të nevojshëm të fëmijës, të përbërë nga certifikatat personale dhe familjare, raporti mjekësor dhe librezë verbërie nga KMCAP-i, vërtetim vendbanimi, librezë vaksinimi dhe epikrizë.

Në fillim të çdo muaji qershor, bazuar në numrin e nxënësve të regjistruar, librat shkollorë kthehen në programin “Brail” nga vetë shkolla.

Kurrikula në këtë institucion përbëhet nga kurrikula bërthamë, kurrikula me zgjedhje dhe orë të kurrikulës shtesë të orientuara<sup>20</sup>.

Plani mësimor është i përbërë nga lëndët e përgjithshme, lëndët speciale dhe kurrikula me zgjedhje. Për lëndët e përgjithshme zbatohen programet lëndore të arsimit bazë sipas kurrikulës së re me kompetenca. Lënda e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit zhvillohet një orë në javë më pak se programi i kësaj lënde në arsimin bazë. Programet lëndore të lëndëve speciale i hartojnë mësuesit e INNSH-sën dhe miratohen nga drejtori i këtij instituti. Në klasën përgatitore, kohëzgjatja e orës së mësimit është 25-30 minuta. Në këtë klasë, në lëndën e gjuhës shqipe zhvilloheshin ushtrime për zhvillimin e të folurit,

---

<sup>19</sup>Neni 64 i Ligjit nr.69/2012: “Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara”, përcakton se: 2. Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkollë të specializuara deri në moshën 19 vjeç. 3. Njësia arsimore vendore krijon një *komision*, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar. 4. Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjejnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira. 5. Ministria, në bashkëpunim me njësien bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara.

<sup>20</sup>Sipas shkresës me nr.4363/1 prot., datë 19.08.2019 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

në shkrimin brail, ushtrime për të prekurin<sup>21</sup>. INNSH-ja dispononte mjete të posaçme didaktike për nxënësit me vështirësi në shikim, si monitor dhe mjete zmadhuese, që i lehtësojnë procesin e mësimit dhe studimit të fëmijëve me probleme në shikim. Çdo material i kurrikulës prodhohet në gjuhën Brail, në shkrim të zmadhuar për nxënësit me shikim të pjesshëm ose me diferencë të ngjyrave për nxënësit me disleksi ose me çrregullime të tjera të të nxënës.

Veçori mjaft pozitive në këtë institut është organizimi i grupeve të vullnetarëve, me qëllim identifikimin e dhuruesve të zërit, për leximin e librave në audio<sup>22</sup>. Kodi apo gjuha Brail njihet dhe pranohet si formë edukimi, informimi dhe komunikimi. Për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve të INNSH-së është krijuar biblioteka audiodigjitale, e cila falë punës së mirë dhe iniciativës së vetë drejtuesit pasurohet çdo ditë. Po ashtu, shtypshkronja e Institutit prodhon vetë librat në gjuhën Brail.

Për problemet psiko-sociale janë dy punonjës të dedikuar të sektorit psiko-social dhe një kujdestare integrimi që merret me aktivitetet e pasditeve në institucion. Veprimtaritë jashtëshkollore organizohen në bashkëpunim me stafin psiko-social, kujdestarin e integritit dhe mësuesin e muzikës. Aktivitetet kulturore zhvilloheshin në orarin e pasdites, si dhe në fundjavë. Në hyrje të godinës ka një kuti ankesash, por na u komunikua se nuk ka patur ankesa nga fëmijët.

Për t'u evidentuar ishin bashkëpunimi i drejtuesit të institucionit me organizata të shoqërisë civile dhe donatorë, për zhvillim aktivitetesh për zhvillimin e fëmijëve, duke ndikuar në përmirësimin e gjendjes emocionale, edukimin dhe argëtimin e tyre. Përgjegjësia dhe pavarësia janë vlera që kjo shkollë u mëson nxënësve që në moshë të hershme.

-Për transportin e fëmijëve/nxënësve në shkollë nuk ka një mjet transporti (furgon), dhe ka nxënës që nuk arrijnë ta frekuentojnë këtë shkollë, vetëm për këtë arsye.

-Problematikë tjetër e evidentuar ishte fakti që vendi i një infermieri ishte vakant, pasi në organigramë janë dy infermierë.

#### **4.Rekomandime të institucioneve/organizmave ndërkombëtare**

---

<sup>21</sup> <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/10/Plani-Mesimor-i-Institutit-te-Femijeve-qe-nuk-Degjojne-1.pdf>

<sup>22</sup> Teknologjia asistive Java Screen Reader dhe NVDA njihen dhe pranohen si mjete ndihmëse për të komunikuar brenda institucionit.

Në kuadër të qasjes për arsimin gjithëpërfshirës që KDPAK-u rekomandon për të gjitha shtetet palë, Komiteti është shprehur se shteti shqiptar duhet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë formulimit, vendosjes dhe zbatimit të objektivave të veçantë për promovimin e një kulture të përfshirjes në arsimin tradicional, si dhe vlerësimeve të individualizuara të kërkesave arsimore në kontekstin e të drejtave të njeriut; ndërgjegjësimit/fuqizimit të prindërve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mbështetjes së fëmijës në familje, shkollë, komunitet dhe qasjen e tyre në shërbimet kryesore. Përfshirja e prindërve dhe komunitetit është i rëndësishëm për cilësinë e arsimit dhe gjithëpërfshirjen, në klasë dhe jashtë saj. Hapi i parë për ndërgjegjësimin dhe fuqizimin e prindërve dhe familjeve për t'u përfshirë në një mënyrë bashkëpunuese me shkollat është promovimi i një atmosfere sociale dhe edukative ku prindërit të ndjehen të mirëpritur, të respektuar, të besojnë që fjala e tyre dëgjohet dhe të ndjehen të dobishëm.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, duke vënë në dukje zhvillimet pozitive që kanë ndodhur në kuadrin ligjor dhe rregullator në avancimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ka sjellë në vëmendje Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 9 (2006) mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe i ka rekomanduar, së fundmi, shtetit shqiptar<sup>23</sup>:

(a) Zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut ndaj aftësisë së kufizuar dhe rritjen e vëmendjes politike dhe investimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara;

(d) Të krijojë një politikë për sigurimin e pajisjeve dhe teknologjisë ndihmëse për të lehtësuar aksesin dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara;

(e) Të sigurojë aksesin në shkolla, qendra të kujdesit shëndetësor dhe hapësirat publike, ndërtesa, shërbime dhe informacion për fëmijët me aftësi të kufizuara;

(f) Të forcojë kapacitetin e profesionistëve për të punuar dhe mbështetur familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në mbështetje të objektivave 4.1–4.7 dhe 4.a të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Komiteti i ka rekomanduar gjithashtu ndër të tjera shtetit shqiptar<sup>24</sup>:

(b) Sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës në mjediset e edukimit të fëmijërisë së hershme dhe shkollat e zakonshme për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duke përshtatur kurrikulat dhe trajnimin dhe duke caktuar mësues dhe profesionistë të specializuar në klasa të integruara, në mënyrë që fëmijët

<sup>23</sup>Pika 32 e Konkluzioneve përfundimtare mbi raportet 5 dhe 6 të Shqipërisë, shtator 2023

<sup>24</sup> Pika 39 e Konkluzioneve të Komitetit të KDF

me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë të marrin mbështetje të individualizuar dhe vëmendjen e duhur, duke u ofruar transportin dhe sigurimin e akomodimit të arsyeshëm në shkolla;

(i) Të sigurojë që aktivitetet e lira, sportive dhe artistike dhe hapësirat e gjelbra të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme në të gjitha bashkitë, veçanërisht për vajzat, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që u përkasin grupeve minoritare dhe fëmijët që u përkasin grupeve të tjera të marginalizuara<sup>25</sup>.

Duke garantuar të drejtën e tyre për t'u arsimuar, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, në zbatim të neneve 18 e 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, si dhe të ligjit nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", kërkohet nga institucionet përgjegjëse ndërmarrja e hapave dhe e veprimeve konkrete edhe në kuadër të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qendrushëm (OQZH 4), për arsimin në vendin tonë.

Bazuar në gjetjet e mësipërme të inspektimit dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin e të drejtave të fëmijëve në interesin më të lartë të tyre dhe, konkretisht, për realizimin e një procesi arsimimi cilësor e gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999,

### **REKOMANDON:**

- Marrjen e masave nga INNSH, në bashkëpunim me ZVAP dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për hartimin e PEI-t për të gjithë nxënësit, si dhe rishikimin e PEI-ve ekzistues.
- Marrjen e masave nga MAS-i për shndërrimin e INNSH-së në qendër burimore.
- Marrjen e masave, për plotësimin e pozicionit vakant në organikën e këtij institucioni edukimi, me infermier, në përputhje me nevojat dhe planet edukative të individualizuara të fëmijëve me AK në mënyrë që të realizohet shndërrimi i saj në qendër burimore.
- Marrjen e masave nga MAS-i, për indeksimin kuotës financiare të ushqimit në mensa e konvikte për nxënësit e arsimit parauniversitar në

---

<sup>25</sup> Konkluzionet përmbyllëse pas raportit të 5-të dhe të 6-të të Shqipërisë për Konventën e të Drejtave të Fëmijës- Concluding observations on the combined fifth and sixth periodic reports of Albania, 17 October 2023, CRC/C/ALB/CO/5-  
<https://documents.un.org/doc/undoc/gen/g23/199/30/pdf/g2319930.pdf?token=mmT718fC2JuohnH4oq&fe=true>

institucionet arsimore vit pas viti në përputhje me ndryshimin e normave të inflacionit.

- Marrjen e masave nga Bashkia e Tiranës, për krijimin e mjediseve të përshtatshme për akses në këtë institucion edukimi, e në mënyrë të veçantë, asfaltimin dhe rregullimin e ambienteve të jashtme (oborrit), si dhe sigurimin e mjetit të aksesueshëm dhe të përshtatshëm të transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

**K O M I S I O N E R**

**OLTA ALIAJ**